



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM
NR 07 DATË 28.02.2022

**MBI MIRATIMIN NË PARIM TË PËRDORIMIT TË NDIHMËS
SË MENJËHERSHME FINANCIARE PËR FAMILJET NË NEVOJË PËR VITIN 2022
NË MASËN 20.000 (NJËZET MIJË) LEKË PËR FAMILJEN E
ZNJ.GJYLE KAZANXHIU**

Këshilli Bashkiak Dimal në mbledhjen e tij të datës 28.02.2022, bazuar në materialin e paraqitur nga Drejtoria Juridike ,në mbështetje dhe zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Neni 41, Neni 53, 54 55, mbështetur në kërkesat e nenit 32 të Ligjit Nr 9936 datë 26.06.2008”Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr 68/2017”Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit Nr 10296 datë 08.07.2010”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr 23 datë 30.07.2018”Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afat mesëm të NJQV”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit Nr 10 datë 28.02.2020”Për përgatitjen e programit buxhetor afat mesëm vendor 2021-2023” dhe shtojcat plotësuese, Udhëzimi Nr 27 datë 10.07.2020”Për përgatitjen e programit buxhetor afat mesëm vendor 2021-2023”, Ligjit Nr 9355 datë 10.03.2005”Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”, i ndryshuar , Vendimi i Këshillit Bashkiak Dimal Nr 82 datë 24.12.2021”Mbi miratimin e programit Buxhetor afat mesëm 2022-2024 dhe detajimin e buxhetit për vitin 2022”, Kërkesës së Sektorit të Ndihmës Ekonomike të Bashkisë Dimal, administruar me shkresën me Nr 4231/1 Prot datë 17.01.2022”

VENDOSI

Me 15 vota PRO nga 15 Këshilltarë prezentë në mbledhje të miratojë:

1. Të miratojë përdorimin e fondit të ndihmës së menjëhershme financiare për familjet në nevojë, për familjen e Znj. Gjyle Kazanxhiu, për vitin 2022, në masën 20.000 (njëzet mijë) lekë.

2. Të miratojë përdorimin e Fondit të Ndhmës së Menjëhershme Financiare,në masën 20.000(njëzet mijë)lekë,për familjen e Znj.Gjyle Kazanxhiu,familje në gjëndje të vështirë ekonomike.KJo familje përbëhet nga 5 (pesë)anëtarë,ndër të cilët të dy bashkëshortët janë të papunë.Të ardhurat e vetme nga të cilat përfitojnë janë nga shitja e materialeve të riciklueshme dhe pagesa si përfitues të ndihmës ekonomike.

3. Shënim:Fondi për vitin 2022,në masën 20.000(njëzet mijë)lekë ,do të përballohet nga fondi ndihmë për familjet në nevojë i parashikuar në buxhetin afatmesëm 2022-2024 të Bashkië Dimal dhe detajimin e buxhetit për vitin 2022.

Kryetar i Këshillit Bashkiak
Hysen Hoxha

